



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

## Njoftim për shpallje

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Rregullores nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, e ndryshuar, si dhe në bazë të Vendimit nr. 19, datë 19.03.2021, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) ka miratuar organizimin dhe funksionimin e testimit për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional për Kontabilistët e Miratuar për periudhën 2014-2019.

1. Për realizimin dhe zbatimin e këtij procesi ngrihet dhe funksionon Sekretariati Mbikëqyrës (SMKVP), i përbërë nga pesë anëtarë:
  - a. Dy anëtarë nga Struktura Mbështetëse e BMP-së (personeli i përhershëm ose komisionet e ngritura pranë tij);
  - b. Një anëtar nga Institucionet e Arsimit të Lartë;
  - c. Dy ekspertë të jashtëm të fushës.
  
2. Anëtarët e Sekretariatit Mbikëqyrës duhet:
  - a. Të kenë shtetësi shqiptare;
  - b. të kenë integritet moral dhe profesional;
  - c. të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
  - d. të kenë përfunduar të paktën studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë një diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar ose të kenë ekspertizë në fushat e ekonomisë dhe/ ose të jurisprudencës, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën.

Kandidatët e parashikuar në germën b) dhe c) të pikës 1, duhet të paraqesin kërkesën drejtpërdrejtë pranë zyrave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Rruga: “Ismail Qemali”, Pallati 5, Kati 2, Apartamenti 8, Tiranë, Shqipëri.

Afati i pranimit të kërkesës është deri më datë **15 Korrik 2021, ora 16:00**.